

PERMBAJTA

DOKUMENTI KRYESOR

1. HYRJE	2
2. ÇESHTJE TE PERGJITHESHME	5
3. QELLIMI I PERGJITHSHEM	6
4. DREJTIMET STRATEGJIKE	7
5. PERSHKRIMI I ÇESHTJEVE TE PERGJITHESHME	10

ANEKSET

	12
1. Matrica e Planit Strategjik: Qellimi i Pergjithshem	12
2. Matrica e Planit Strategjik: Objektivi 1	13
3. Matrica e Planit Strategjik: Objektivi 2	14
4. Matrica e Planit Strategjik: Objektivi 3	15
5. Analiza SWOT e FSHSHC	16
a. Grafiku i Pershkrimit te Analizes SWOT	18
6. Problemet e ShC Shqiptare	19
7. Pema e Problemit	22
8. Analiza e Grupit te Interesit	23
9. Harta e Shqiperise qe paraqet Shperndarjen e Shoqerise Civile	25

LISTA E SHKURTIMEVE

26

Plan Strategjik Tre-Vjecar

Shtator 2005

I. HYRJA

Fondacioni Shqiptar i Shoqerise Civile (FSHSHC) u krijua ne Janar 1995 si nje organizate jo-fitimpruese shqiptare per te kontribuar ne zhvillimin e sektorit jo-fitimprues ne Shqiperi. Ai e filloi aktivitetin e tij me nje synim te qarte per nxitjen e fuqizimit te sektorit te trete (jofitimprues). Gjate nente viteve Fondacioni ka punuar per realizimin e ketyre aktivitetve dhe praktikave:

- Asistence shoqatave te sapo krijuara qe aplikonin per grante.
- Zhvillim kapacitetesh permes kurseve te rregullaa te trainimit per OJFte shqiptare
- Mbledhje dhe shperndarje informacioni mbi aktivite te OJFve ne te tere Shqiperine dhe krijimin e bazes se te dhenave per sektorin.
- Qendra e Sherbimeve per Qytetaret e cila iu ofronte OJF-ve mbeshtetje per te realizuar aktivitetet e tyre.
- Studime dhe botime :
 - Legjislacioni qe rregullon aktivitetet e OJF-ve Shqiptare.
 - Rezultatet e nje anketimi te realizuar ne bashkepunim me Institutin Kombetar te Statistikave.
 - Kater broshura te tjera studimore rreth shoqerise civile, te drejtat e minoriteve, Konventat Europiane, maredheniet nderetnike dhe kulturat si ura lidhese te miqesise, jane botime te FSHSC.
 - Manuali mbi Menaxhimin e Ciklit te Projektit dhe Metoda e Kornizes Logjike eshte kontributi ne kete fushe i FSHSHC i botuar kohet e fundit.
- Bashkepunim i vazhdueshem me te gjitha fondacionet e huaja dhe shqiptare brenda dhe jashte vendit. Ne shume raste Bordi ka bashke-financuar aktivite te OJF-ve me Fondacionin SOROS, Qendren Rajonale te Mjedisit , Qendren Shqiptare te te Drejtave te Njeriut etj.
- Sponsorizimi i aktiviteve per te nxitur zhvillimin e shoqerise civile dhe permiresimin e maredhenieve shoqerore ne vendin tone. Nje nga te parat (zhvilluar ne shkurt 1996) ishte Konferenca Nderkombetare per Lirine e Besimit ne Shqiperi dhe Besimin e Minoriteve.
- Maredheniet Nderetnike permes projektit "Mirekuptimi Nderetnik dhe te drejtat e minoritetit " ne rajonet jugore te vendit ku jetojne nje pjese e minoriteve u zbatua ne bashkepunim me Fondacionin Soros dhe me mbeshtetjen financiare te Fondacionit King Baudouin .

Gjate ketyre viteve FSHSHC ka mbeshtetur 178 OJF permes 236 granteve dhe me nje fond 400.000 \$ te dhene per te zbatuar projekte ne te gjithe vendin.

Cilesia e punes dhe praktikat me te mira te aplikuar nga FSHSHC kane bere qe Fondacioni te mbeshtetet nga nje numer donatoresh vendas dhe nderkombetare pervec fondeve baze nga DANIDA te cilat perfunduan ne 2002. Fondet e ngritura per aktivitetet e 2003 ishin rreth 100.000 \$ dhe pothuajse te njejta per 2004 gje qe deshmon per aftesi per ngritje fondesh dhe cilesi te mire te Projekt Propozimeve te FSHSHC.

Partneret lokale (OJFte lokale), te cilet kane efektivitetet te madh per veprimtarine ne qytete te tjera te Shqiperise, kane qene nje aspekt i rendesishem i punes se FSHSHC gjate ketyre viteve. Forcimi i kapaciteteve si dhe pavaresia apo "transferimi i pronesise" kane cuar ne nje bashkepunim te frytshem .

Duke ndjekur me kujdes procesin e zhvillimit te SHC Shqiptare ne e kuptojme se ka ende shume probleme dhe shqetesime te cilat mund te pershkruhen shkurtimisht si vijon:

Megjithese Republika e Shqipërisë ka nje sektor jo-qeveritar shume te gjere (i cili perbehet nga rreth 600 apo me shume organizata te ndryshme te shoqerise civile), ai eshte ende i shperbere, nuk eshte koherent dhe kooperues ne krahasim me ate te Shteteve anetare te BE.

OJF-ve iu mungojne bashkepunimi, lehtesirat, rrjetet, kanalet e informimit dhe vecanerisht ekspertiza dhe njohurite per menyren se si te aplikojne per projekte, si te menaxhojne dhe shperndajne rezultatet, si te perdorin lobimin dhe si te zhvillojne dialog me Qeverine. Ne menyre te permbledhur mund te shprehemi se shumica e OJF-ve nuk jane aq te zhvilluara sa te behen partnere te rendesishem me Qeverine dhe ne nje faze te mevonshme, pas asocijimit, edhe me institucionet e BE. OJF-te vazhdojne te kene mangesi ne fushen e profesionalizmit, transparences se aktivitetit te tyre dhe politikave te stafit.

OJF-te vuajne nga mungesa e anetaresimit te gjere, e pergjegjesise shoqerore te grupit dhe bashkepunimi i varfer ne rrjete. OJF-te po ashtu kane mangesi ne drejtim te planifikimit strategjik, strukturave te menaxhimit dhe perdorimit te teknologjise bashkekohore.

Anetaret e Bordeve nuk jane te pergatitur per rolin e tyre dhe financimi i OJF-ve mbetet i orjentuar dhe i varur nga donatori, d.m.th i pamjaftueshem per zhvillimin e qendrueshem te ketij sektori.

Vetem disa organizata te shoqerise civile aktualisht bashkepunojne me organizatat koresponduese te BE dhe marrin pjese me sukses ne tenderat publik jashte vendit, por shumica e tyre kane struktura zhvillimi teper te dobeta dhe nuk kane aftesi te mjaftueshme per te ndikuar as mbi politikat e qeverise e as mbi politike-berjen e BE duke hyre ne platformat Europiane.

Shqiperia po kalon nje proces decentralizimi i cili duhet ende te konsolidohet. Ndersa autoritetet lokale duhen fuqizuar, roli i qytetareve ne procesin demokratik lokal shpesh ka nevojte te shprehet me mire dhe te inkurajohet. Vecanerisht ne nivel lokal ndikimi dhe mundesite e individit per te influencuar rrjedhen e politikës mund te jene shume me te prekshme se sa ne nivel kombetar. Nese qytetaret arrijne te ndejne ndikimin e tyre ne nivel lokal, atehere do te forcohet demokracia ne te gjitha nivelet.

Shume njerez besojne se sot per sot nuk ka Shoqeri Civile te vertete ne Shqiperi, as edhe ndonje opsion politik qe do te mbeshteste perpjekjet e nje shoqeri civile.

Me synimin per te siguruar zhvillim te vazhdueshem ne te ardhmen te komunitetit ekzistues te OJF-ve dhe me shtytjen e dhene nga NOSA per te vazhduar procesin pas fazes se pare, FSHSHC filloi procesin e Planifikimit Strategjik per nje periudhe kohe tre-vjecare.

Stafi i FSHSHC dhe dy anetare te bordit kane kontribuar shume per pergatitjen e ketij plani. Ato filluan procesin ne fillim te muajit Qershor 2004 kur strategjia e NOSAs u be publike per OJF-te. Ne fakt, i gjithë procesi u bazua ne analizen e situates se tanishme te Shoqerise Civile ne Shqiperi te pershkruar shkurtimisht me lart , ne analizen SWOT te FSHSHC-se dhe ne identifikimin e problemeve kyçe qe sherbejne si nje kornize per te shtjelluar planifikimin stategjik. Perpjekjet e FSHSHC-se per Zhvillimin Institucional dhe Fuqizimin

Organizativ si dhe zhvillimin e shoqerise civile ne pergjithesi ishin pjeset baze te procesit te planifikimit.

Gjate kesaj periudhe kohe u bene hapat e permendura me poshte :

- Personat kryesore (nga stafi dhe bordi) u perfshine ne procesin e hartimit.
- Analiza e situates aktuale te zhvillimit te shoqerise civile ne Shqiperi.
- Percaktimi i problemeve lidhur me zhvillimin e shoqerise civile ne Shqiperi si dhe i prioritetetve per te arritur ne problemin thelbesor.
- Problemi thelbesor prioritar u analizua me ndihmen e analizese se pemes se problemit.
- Pema e objektivave dhe alternativa e Objektivave ishin hapi tjetër i realizuar.
- Percaktimi dhe qartesimi i parametrave te planifikimit.
- Percaktimi i kornizes strategjike:
 - **Vizion** i shprehur qarte;
 - **Vlera** te formuluar qarte ;
 - **Misioni**, i shprehur ne nje deklarate misioni;
 - **Qellimi i pergjithshem** i organizates;
 - **Objektivat afatshkurtera** te orgnaizates ;
 - **Drejtimit e rezultateve baze** ne te cilat organizata synon te perqendrohet;
- Analiza perfundimtare SWOT e FSHSHC
- Percaktimi i strategjive te mundshme dhe drejttimeve strategjike;
- Percaktimi i vizionit perfundimtar dhe plotesimi i planit strategjik;
- Percaktimi i planit te detajuar per zbatim permes percaktimit te kornizes logjike;

Wilbert Schouten dhe Rene Bastiaanssen, of SNV – Shqiperi, kane ndihmuar ne kete proces qe u drejtu nga Pandeli Theodhori, Drejtor Ekzekutiv i FShShC.

U realizuan intervista me 4 OJF me te cilat bashkepunon FSHSHC, me tre donatore, me perfaqesues te qeverise lokale si dhe perfaqesues te grupeve te synuara per te siguruar informacionin mbi pozicionimin e mjedisit ndaj punes se FSHSHC.

Si rezultat i procesit te planifikimit strategjik u percaktuan prioritetet e meposhtme per FSHSHC per tre vitet e ardheshme:

1. Fuqizimi i Shoqerise Civile ne Zonat Periferike (ZP) te Shqiperise.

2. Zhvillimi i Shoqerise Civile per Partneritet te Permiresuar me Qeverine ne Zonat Urbane (ZU) .

3. Perdorimi i TIK per Zhvillimin e Shoqerise Civile dhe Perfshirjen e saj me te madhe ne Monitorimin e Ecurise te SKZHES.

II. ÇESHTJE TE PERGJITHESHME

VIZIONI

Ne jetojme ne nje bote ku çdonjeri prej nesh eshte ne partneritet me te gjithë te tjeret; ku cilesia e jetes se çdo individi lidhet ngushte me mireqenien e komunitetit lokal dhe rajonal; dhe ku zhvillimi bazohet ne maredheniet e harmonizuara mes Qeverise Qendrore dhe Lokale, Komunitetit te Biznesit dhe Sektorit Jofitimprures.

Ne i permbahemi ketij vizioni permes aktiviteteve krijuese, komunikimit efektiv dhe aktiviteteve te tjera qe fuqizojne komunitetin ne shume forma per nje shoqeri civile te zhvilluar dhe te hapur.

VLERAT BAZE :

1. FSHSHC eshte e angazhuar ne maredhenien Horizontale e cila eshte me produktive sesa ajo Vertikale.

- o Gjithmone behet planifikim i mire dhe pergatitje e aktiviteteve.
- o FSHSHC angazhohet per realizimin e detyrave ne kohe;
- o Punojesit sillen mire dhe me respekt ndaj njeri-tjetrit;
- o FSHSHC gjithnje e arrin suksesin,

2. Proceset e brendeshme te FSHSHC bazohen ne kooperim, bashkepunim dhe frymen e punes ne grup.

- o Ne i kushtojme kohe dhe perpjekje krijimit te sherbimeve dhe produkteve sasiore dhe cilesore ne baze te vlerave profesionale te saktësisë, angazhimit, interesimit etj.

3. Aktivitetet tona te jashtme nxisin fuqimisht krijimin e koalicioneve dhe rrjeteve.

- FSHSHC beson se eshte me mire te punosh ne grup apo ne rrjet sesa individualisht.
- Koalicionet e bejne me te lehte per qeverine lokale t'i permbahet ligjeve qe kerkojne inpute nga OSHC-te ne vendim-marrje.
- Ka patur shume fryme grupi ne punet e kryera ne bashkepunim me te tjeret;

4. Ne shkembjeme informacion me organizata te tjera te ngjashme sipas nevojës dhe e konsiderojme te mesuarin si proces te vazhdueshem.

- Ka stimul te larte pune dhe çdonjeri kontribuon;
- FSHSHC i pranon gabimet si përvije nga e cila mund te mesohet dhe te shkohet drejt suksesit;

5. Ne gjithnje jemi mirenjohes ndaj donatoreve.

- FSHSHC gjithnje i respekton donatoret,

MISIONI

FSHSHC është një Organizatë Jo-fitimprurëse Shqiptare e cila synon të nxisë dhe të zhvillojë Shoqërië Civile në Shqipëri , duke i dhënë përparësi zonave urbane larg kryeqytetit dhe duke u përqendruar në zonat periferike në veçanti. FSHSHC do të shumfishojë përpjekjet e tij për komunitetet e atyre zonave në bashkëpunim të ngushtë me vetë ato, me Organizatat e SHC dhe me Qeverinë Lokale për Edukimin Qytetar dhe Pjesëmarrjen e komunitetit, për të krijuar një shoqëri të hapur, të drejtë, të barabartë dhe me zhvillim Demokratik të qendrueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Fondacioni synon të përforcojë tek njëzërit dhe organizatat e tyre, atë që quhet “kapacitet për të përbushur qëllimin .”

OBJEKTIVAT AFAT-GJATA

- ◆ Shoqërië Civile e fuqizuar në Shqipëri për të garantuar Demokracinë
 - Një shoqëri civile aktive dhe e larmishme luan rol me vlerë në çuarjen përpara të demokracisë dhe disiplinimin e shtetit që të sigurojë trajtimin me seriozitet të interesave të shtetasve.
- ◆ Qeveria Qendrore dhe Lokale luajnë një rol të vlefshëm në zhvillimin e një shoqërie civile të shëndetshme.
 - Një sistem rregullash të miratuara, të qarta dhe të zbatueshme për sektorin jo-qeveritar.
- ◆ Shoqëria Civile Shqiptare një mjet efikas për të garantuar metodën e orjentuara tek qytetarët në procesin e vendim-marrjes.

III. QELLIMI I PERGJITHSHEM

Shoqëria Civile Shqiptare e fuqizuar si mjet për qytetarët që të kontribuojnë efektivisht për Demokracinë dhe Zhvillimin.

Objektivat afat-shkurtera:

- Shoqërië Civile e fuqizuar në Zonat Periferike (ZP) të Shqipërisë.
- Shoqërië Civile e aftësuar për një Partneritet me të fuqishëm me Pushtetin Vendor në Zonat Urbane (ZU) .
- TIK e përdorur me efektivitet për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, për Imazhin Publik të saj dhe Përfshirjen e përmirësuar në Monitorimin e ecurisë së SKZHES.

IV. DREJTIMET STRATEGJIKE


Drejtimet strategjike te meposhtme theksojne veprimet e ardheshme te FSHSHC per gjithëcka duhet bere per arritjen e objektivave strategjike afat-shkurtera si dhe rruget perkatese per arritje e tyre. Aktivitetet e detajuara me afatet kohore, personat pergjegjes, buxheti i nevojshem me burimet financiare dhe treguesit per zbatim do te zhvillohen dhe paraqiten ne nje date te mevonshme pasi ato e kalojne kufirin e kesaj paraqitjeje te strategjise. Disa dokumenta mbeshtetes perfshihen si anekse ne fund te dokumentit kryesor.

DREJTIMET BAZE

- * Ndermarrja dhe zbatimi i iniciativave qe demonstrojne rendesine e zhvillimit dhe rolin e sektorit jo-fitimprures ne Shqiperi.
- * Nxitja dhe fuqizimi i sektorit te Shoqerise Civile ne zonat periferike.
- * Ngritja e qendrave te edukimit qytetar te komunitetit (QEOK) per nje zhvillim te qendrueshem dhe bashkepunim me Pushtetin Vendor te zonave periferike.
- * Nxitja e aktiviteteve te Sektorit te Shoqerise Civile ne zonat periferike permes krijimit te kapaciteteve dhe fushatave per sigurim fondesh.
- * Fuqizimi i aftesive organizative te Shoqerise Civile ne zonat urbane.
- * Zhvillimi i mekanizmave te menaxhimit te dijeve dhe shkembimit te informacionit.
- * Perdorimi i TIK per zhvillimin e Shoqerise Civile, imazhin publik te saj dhe pjesemarrjen si ne zonat periferike edhe ato urbane.

METODA E PUNES

- * Ne punen e tij, FShShC perqendrohet dhe bashkepunon njesoj si me burrat ashtu dhe grate;
- * Realizimi i ndikimit ne nivel lokal kontribuon ne fuqizimin e demokracise dhe zhvillimit ne te gjitha nivelet .
- * FSHSHC investon ne edukimin e te rinjve per te garantuar te ardhmen.
- * Permes percjelljes se pervojes dhe dijeve te tij, FSHSHC krijon parakushte per pune te suksesshme te OJF-ve te tjera ne tere Shqiperine;




GRUPET E SYNUARA

- * Komunitetet ne zonat periferike (ZP),
- * OJFte ne zonat urbane.
- * GBK dhe organizatat e tjera ne zonat e largeta .
- * Grupet etnike, minoritetet dhe grupet ne nevoje.
- * Autoritetet dhe Institucionet Shteterore dhe Lokale ;
- * Media;

STRUKTURA

Struktura e parashikuar e FSHSHC per vitin 2006 do te jete si vijon :



Ne kete Organigrame, Koordinatorët e Projekteve do te nenkontraktohen nga OJF-te lokale te zgjedhura permes nje procesi thirrjeje per Projekt Propozime mbi temat e perfshira ne planin e veprimeve per realizimin e objektivave afat-shkurtera.

RRJETET

FSHSHC ka patur bashkepunim te frytshem me OJF-te lokale. Ne kemi vene ne funksionim dhe mbeshtetur aktivitetin e shtepive te OJF-ve ne Peshkopi, Burrel, Bulqize dhe Permet. Me ngritjen e QEK ne Kelcyre u krijua nje mjedis i ri per bashkepunim te metejshe. Kontakte te tjera bashkepunimi ne kemi ne 16 rrethe te Shqiperise ne baze te bashkepunimit dhe mbeshtetjes financiare qe FSHSHC ka realizuar ne to. (Referojuni pyetsorit te meparshem te NOSA). Duke perfituar nga ky mjedis pozitiv, nga pervoja jone me e mire ne terren dhe veprimet e ardheshme permes NOSAs , do te jete shume e lehte per te krijuar rrjete vepruese te OJF-ve si ne zonat urbane ashtu edhe ato periferike. Ne do te perfshijme organizatat me te sukseshme me rezultate te rendesishme ne aktivitetet e peparshme nga zonat urbane per te kooperuar me OJF-te ne zonat periferike dhe do te krijojme tre rrjete te cilat do te kooperojne me FShShC per asistence dhe konsulence. Rrjetet si organizma te pavarurura do te vazhdojne te punojne ne baze te statuteve dhe pronesise te tyre perkatese.

BURIMET

Zyrat

FShSHC ka marre me qera zyrat me nje pagese prej 400 dollaresh (usd)/ne muaj . Salla me e madhe sherben per organizimin e trainimeve dhe eshte e pajisur per kete qellim.

Pajisjet

FSHSHC ka 9 PC- makine fotokopje, scanner , tre printera , TV , VCR, projektor dhe dhe te gjitha pajisjet e nevojshme per zyra per te kryer nje aktivitet normal. Transporti eshte siguruar permes makines qe disponon FSHSHC.

Burimet Njerezore

FShShC do te vazhdoje te mbeshtet ne pervojen e personelit aktual (4 persona) dhe delegimin (nen-kontraktimin) e pergjegjesive dhe aktiviteteteve tek OJF-te profesioniste dhe te afta apo grupeve te ngritura enkas sipas qellimit te aktiviteteteve. Ne sejcilin grup do te perfshihen persona te trainuar dhe me pervoje.

Burimet Financiare

Duke filluar nga 2002, pas mbarimit te programit te mbeshtetur nga DANIDA, FSHSHC vazhdoi aktivitetet e tij permes hartimit me profesionalizem te Projekt Propozimeve te pershtatshme . Kjo cilesi beri te mundur sigurimin e nje buxheti prej 100.000 \$ per vitin 2003 (shih Raportin Vjetor 2003) dhe pothuajse te njejten shume per vitin 2004. FSHSHC po vazhdon te aplikojte tek Donatore nderkombetare duke perfshire Programin e financimit CARDS te BE madje edhe permes Programit Rrjeti tek Rjeti si anetare e Rrjetit te Zhvillimit te Shoqerise Civile Ballkanike. FShShC ende nuk ka arritur te perfitoje nga fondet publike kombetare. Donoret e Mundshem per mbeshtetjen e Projekt Propozimeve te FSHSHC mund te jene :

Fondi Marshal Gjerman; Balkan Trust; DFID, Komisioni i BE; Qendra Palme; Ambasadat ne Tirane ,etj.

BASHKEPUNIMI

FSHSHC eshte nje institucion me reputacion dhe e perfshire ne rrjete kontribuesish, organizatash dhe institucionesh nga Shqiperia, Ballkani, Europa dhe bota.

FSHSHC eshte anetare asistuese e CONCORD dhe anetare e Rrjetit te Zhvillimit te Shoqerise Civile Ballkanike. Bashkepunimi luan nje rol te rendesishem ne zhvillimin e FSHSHC-se, permes pjesemarrjes aktive, ofrimit te asistences teknike dhe trainimit.

Qendrat e Edukimit dhe Komunikimit te Komunitetit ne Peshkopi, dhe Kelcyre, Forumet e OJF-ve ne Permet, Burrel, Kruja,etj dhe QZSHHC do te jene nje burim i mire bashkepunimi per zbatim projektesh permes strukturave te tjera.

V. PERSHKRIMI I ÇESHTJEVE TE PERGJITHESHME

OBJEKTIVAT AFAT-SHKURTERA TE DETAJUARA

Objektivi 1. Shoqeri Civile e fuqizuar ne Zonat Periferike (ZP) te Shqiperise

Situata e tanishme: Zonat periferike pershkruhen ne harten e bashkengjitur ketij dokumenti. Ne zonat si Bilisht, Leskovik, Delvine, Çorovode, Kurbin, Koplík, Fushe Arrez, Memaliaj etj. nuk ka pothuajse aspak aktivitet te shoqerise civile dhe nuk eshte krijuar ende asnje OJF. Po ashtu verehet aktivitet shume i paket ne zonat periferike si Bulqize, Burrel, Permet, Kelcyre, Tepelene, etj. Si rezultat nuk ka perfshirje dhe as ndikim te Shoqerise Civile. Kolona e trete perfaqesuese e sektorit jo-fitimprues eshte shume e pafuqishme per te kontribuar per nje shoqeri te zhvilluar dhe te qendrueshme.

Pse duhet nderhyre ne ZP?

- ◆ OJF-te njihen si komponente te rendesishem te shoqerise civile dhe sigurojne nje mbeshtetje te vlefshme per nje sistem demokratik qeverisjeje".
- ◆ Shoqeria Civile ka nevojte per fuqizim sepse aktualisht nuk eshte e afte te kryeje rolin e saj te fuqishem pozitiv.
- ◆ Vecanerisht ne nivel lokal ndikimi i individit dhe mundesia per te influencuar ne rrjedhen e politikës mund te jene shume me te prekshme sesa ne nivel kombetar.

NDERHYRJET KRYESORE:

- 1.1 Transmetimi i Informacionit dhe njohurive per Shoqeri Civile tek GBK ne ZP.
- 1.2 Rritja e ndegjegjesimit publik per rolin dhe kontributin e sektorit jo-fitimprues ne ZP.
- 1.3 Krijimi dhe fuqizimi i komunitetit te OJF-ve ne nivele baze te ZP.
- 1.4 Ngritja e QEQK (Qendra e Edukimit Qytetar te Komunitetit) ne disa rrethe pilot te ZP.

Objektivi 2: Shoqeri Civile e afte per Parteritet me te fuqishem me Pushtetin Vendor ne Zonat Urbane (ZU).

Situata e Tanishme: OJF-te mbeten ende te pafuqishme persa i perket planifikimit strategjik, strukturave menaxhuese dhe perdorimit te teknologjise bashkekohore. Shqiperia po kalon nje proces decentralizimi i cili duhet ende te konsolidohet. Nderkohe qe autoritetet lokale kane nevojte te forcohen, roli i qytetareve ne procesin lokal te demokratizimit shpesh ka akoma nevojte te shpjegohet me mire dhe te inkurajohet .

Pse duhet aftesuar Shoqeria Civile?

- ◆ Organizatat e shoqërisë civile kanë nevojë të ndihmohen për të kuptuar se aftësia e tyre për t'u orjentuar nga misioni lidhet drejtpërdrejt me lirinë e tyre financiare.
- ◆ Akoma më i rëndësishëm është aftësimi i sektorit jo-fitimprurës për të kërkuar politika publike të drejta dhe të paanshme të financuar nga taksat
- ◆ Për të siguruar që drejtësia shoqërore të jetë misioni i përgjithshëm që drejton të gjithë sektorin.

NDERHYRJET KRYESORE:

2.1 Zhvillimi i Aftësive Organizative të mjaftueshme të OJF-ve në zonat urbane.

2.2 Permiresimi i profesionalizmit dhe transparencës së OJF-ve në zonat urbane.

2.3 Permiresimi i Kuadrit Ligjor dhe sistemit të taksave për sektorin jo-fitimprurës.

2.4 Bashkëpunimi Shoqëri Civile -Qeveri për planifikimin e zhvillimit lokal (strategjite) dhe shërbimet sociale.

2.5 Zhvillimi i mekanizmave të menaxhimit të dijeve dhe shkëmbimit të informacionit.

2.6 Ngritja e rrjeteve kombëtare apo ndërmjetësimi për bashkëpunim me të mirë brenda sektorit

2.7 Krijimi i rrjeteve ndërkombëtare dhe realizimi i aktiviteteve për mobilizim të burimeve .

- **Objektivi 3: TIK e përdorur me efektivitet për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Imazhin Publik të saj dhe Përfshirjen e përmirësuar në Monitorimin e ecurisë së SKZHES.**

Situata e Tanishme: OJF-te vazhdojnë të jenë të pafuqishme në fushën e profesionalizmit, transparencës së aktivitetit të tyre dhe politikave të stafit. Nuk kanë anëtarësi të gjera, bashkëpunimi në rrjet është i varfër, dhe iu mungon përgjegjësia shoqërore e vertetete e punës në grup. Nga këndvështrimi ndërkombëtar, sektori jo-fitimprurës në Shqipëri rezulton se është i izoluar, ka humbur besueshmërinë dhe ka Imazh Publik të ulët.

Pse duhet nderhyre ?

- ◆ Shkëmbimi i shpejtë dhe i lehtë i informacionit, aksesit elektronik për zhvillim kapacitësh dhe informacioni për mobilizim burimesh do të nxisin mundësitë e zhvillimit të Shoqërisë Civile Shqiptare.
- ◆ Transparenca e aktiviteteve të Shoqërisë Civile përmes TIK do të përmirësojë Imazhin Publik dhe besueshmërinë e sektorit jo-fitimprurës.
- ◆ TIK do të rrisë në mënyrë cilësore dhe sasore përfshirjen e Shoqërisë Civile në vendim-marrjen për politikën dhe Monitorimin e SKZHES në nivel kombëtar dhe lokal.

NDERHYRJET KRYESORE :

3.1 Zhvillim Kapacitësh online: Rreth Studimor mbi temën të ndryshme.

3.2 Përfshirja aktive e OJF-ve dhe komunitetit në Monitorimin dhe Vlerësimin e Procesit të zhvillimit. (OZHM dhe SKZHES)

3.3 Përdorimi i TIK për transparencën e aktiviteteve dhe Imazhin Publik të OJF-ve .(Portal online për Organizatat e Shoqërisë Civile)

ANEKS 1: MATRICA E PLANIT STRATEGJIK-QELLIMI I PERGJITHSHEM DHE OBJEKTIVAT AFAT-SHKURTERA

Pershkrimi I QELLIMIT TE PERGJITHSHEM	Treguesit	Mjetet e Verifikimit	Supozimet
<p><u>OBJEKTIVAT E PERGJITHESHME:</u></p> <p>1. Ndikim i mjaftueshem mbi Demokratizimin.</p> <p>a. Barazi sociale per grupet etnike/minoritetet.</p> <p>b. Dallimet mes Zonave Rurale-Urbane te reduktuara</p> <p>2. Ndikim i mjaftueshem ne Zhvillim</p> <p>a. Vendim-marrja me pjesemarrje te rritur dhe te permiresuar.</p> <p>b. Planifikim i pershtatshem zhvillimi ne nivele te ndryshme.</p> <p>3. Permiresim ne perdorimin e TIK per zhvillimin dhe pjesemarrjen e Shoqerise Civile.</p>			
<p><u>QELLIMI I PERGJITHSHEM:</u></p> <p>Shoqerisa Civile Shqiptare e fuqizuar si mjet per qytetaret qe te kontribuojne efektivisht per Demokracine dhe Zhvillimin</p>	Ndikimi (impakt)i mjaftueshem i ShC ne Zhvillim dhe Demokraci ne fund te periudhes tre-vjecare.	Raportet dhe dokumentat e tjere mbi ecurine e Demokracise/ Zhvillimit ne Shqiperi	Stabiliteti Politik dhe Ekonomik i garantuar. Komunitetet dhe OJF-te marrin pjese
<p><u>Objektivat afat-shkurtera:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Shoqeria Civile e fuqizuar ne Zonat Periferike (ZP) te Shqiperise. ◆ SHC e afte per Partneritet me te fuqishem me qeverine ne Zonat Urbane (ZU). ◆ TIK e perdorur me efektivitet per Zhvillimin e SHC, Imazhin Publik te saj dhe perfshirjen e permiresuar ne Monitorimin e ecurise se SKZHES. 	Numri i OJF-ve te reja dhe ndikimi ne progresin demokratik ne ZP. Numri i OJFve te qendrueshme dhe aktivitetet ne zonat urbane. Cikel Studimi per Zhvillimin e ShC 3 Forume vjetore te ShC per monitorimin e ecurise se SKZHES ne shkalle rajonale.	Statistika per sektorin jo-fitimprues ne ZP dhe zonat urbane. Shenimet nga diskutimet ne seminarat praktike (workshop)rajonale	Komunitetet dhe OJF-te te gatshme per pjesemarrje. Fonde te disponueshme . Kapacitete trainimi te siguruara . Pjesemarrja dhe bashkepunimi me Qeverine tsiguruara.
<p><u>NDERHYRJET KRYESORE:</u></p> <p>1.1 Transmetimi i informacionit dhe njohurive per ShC tek GBK ne ZP.</p> <p>1.2 Rritja e ndergjegjesimit Publik per rolin dhe kontributet e sektorit jo-fitimprues ne ZP.</p> <p>1.3 Krijimi dhe fuqizimi i komunitetit te OJF-ve ne nivele baze te ZP.</p> <p>1.4 Ngritja e QEQK (Qendrave te Edukimit Qytetar te Komunitetit) ne disa rrethe pilot te ZP.</p> <p>2.1 Zhvillimi i Aftesive Organizative te mjaftueshme te OJF-ve ne zonat urbane .</p> <p>2.2 Permiresimi i profesionalizmit dhe transparences se OJFve ne zonat urbane.</p> <p>2.3 Permiresim i kuadrit ligjor dhe sistemit te taksave per sektorin jo-fitimprues.</p> <p>2.4 Bashkepunimi ShC-Qeveri per planifikimin e zhvillimit lokal (strategjite) dhe sherbimet sociale.</p> <p>2.5 Zhvillimi i mekanizmave te menaxhimit te dijeve dhe shkembimit te informacionit</p> <p>2.6 Ngritja e rrjeteve kombetare apo ndermjetesimi per bashkepunim me te mire brenda sektorit</p> <p>2.7 Krijimi i rrjeteve nderkombetare dh aktiviteve per mobilizim burimesh</p> <p>3.1 Zhvillim Kapaciteti online: Cikel Studimi me tema te ndryshme.</p> <p>3.2 Perfshirje aktive e OJFve dhe komunitetit ne Monitorimin dhe Vleresimin e procesit te zhvillimit . (OZHM dhe SKZHES)</p> <p>3.3 Perdorimi i TIK per transparence te aktiviteve dhe Imazhin Publik te OJF-ve .(Portal online per Organizatat e SHC)</p>	<p>25 komunitete lokale te informuara dhe trainuara mbi Ceshtjet e ShC.</p> <p>Numri. I fushatave ndergjegjesuese ne Z P.</p> <p>Numri I OJFve te reja te krijuara dhe qe operojne .</p> <p>Numri i QEQK te ngritura ne ZP.</p> <p>Nr i trainimeve dhe temave te trajtuara.</p> <p>Nr. i OJFve te trainuara dhe raporteve financiare te paraqitura.</p> <p>Nr. i neneve te permiresuara dhe te miratuara nga ligjvenesit.</p> <p>Nr. I perfshirjeve dhe ndikimeve te programeve zhvilluese ne zona.</p> <p>Nr. i strategjive lokale te hartuara.</p> <p>Kapaciteti i Databases dhe portal ne sherbim te komunitetit te OJFve.</p> <p>Nr. i temave ne Ciklin e Studimit.</p> <p>Monitorimi i ecurise se SKZHES online. (www.regions.org)</p> <p>Portal online i Transparences</p>	<p>Raporte dhe dokumenta te tjera.</p> <p>Vendime Gjykate dhe dokumenta te tjera.</p> <p>Raporte mbi seminarat praktike (workshops) dhe tekologjine e perdorur.</p> <p>Raporte dhe dokumenta te tjera. Gazeta Zyrtare.</p> <p>Dokumenta te shkruara</p> <p>Faqe web aktive qe perfaqeson sektorin.</p>	<p>Informacion dhe Njohuri te disponueshme. Dëshira per te marre informacion etj.. Infrastruktura e pershtatshme.</p> <p>Fonde dhe kapacitete te siguruara . Ka vullnet te mire dhe bashkepunimi eshte i mundshem.</p> <p>Deshire pe bashkepunim.</p> <p>Bashkepunimi dhe mirekuptimi te garantuara . Infrastruktura e pershtatshme</p> <p>Fonde dhe kapacitete te siguruara.</p>

ANEKSI 2: MATRICA E PLANIT STRATEGJIK –DETAJE TE PASQYRES 1:

Objektivi afat-shkurter 1

Pershkrimi i PROGRAMIT	Treguesit	Mjetet e Verifikimit	Supozimet
<p><u>OBJEKTIVAT E PERGJITHESHME:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Dallimet mes zonave rurale-urbane te redukt.uara. Planifikim i pershtatshem i zhvillimit lokal. Kushte jetese te permiresuara ne ZP. 			
<p><u>Objektivi Afat-shkurter 1:</u> Shoqeri Civile e fuqizuar ne Zonat Periferike (ZP) te Shqiperise.</p>	<p>Numri i aktiviteteve te OJFve te reja dhe ndikimi i tyre ne progresin e demokratik.</p>	<p>Statistika per sektorin jofitimprues ne ZP.</p>	<p>Komunitetet dhe OJFte te gatshem per pjesemarrje. Fonde te disponueshme . Kapacitete trainimi te siguruara .</p>
